



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 10 Mars 2021

Nr: 130

VENDIM

**PËR KTHIMIN PËR KORRIGJIM TË DOKUMENTACIONIT TË LISTËS  
SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR DEPUTET TË DEPOZITUAR NGA  
“PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË” PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË  
DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, neni 67, neni 72 dhe neni 73, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe Udhëzimit nr.1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

V Ë R E J

“Partia Socialiste e Shqipërisë” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.

Në bazë të neneve 67 e 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, “Partia Socialiste e Shqipërisë” ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore për 12 zona zgjedhore.

Në bazë të nenit 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumëmemërore të kandidatëve për deputet të “Partisë Socialiste Shqipërisë” dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur. Në përfundim të procesit të verifikimit paraprak u konstatuan mangësi dhe mospërmbushje të dokumentacionit si më poshtë:

1. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Elbasan** nuk është në përputhje me kriterin gjinor të përcaktuar në pikën 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor;
2. Deklarata e Kandidatit (Model 05) për kandidatin për deputet me numër rendor 9, zj. Ana Dhamo, **Qarku Durrës**, rezulton i pa plotësuar;



3. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 12, z. Arkend Balla, **Qarku Durrës** rezulton se faqja 1 dhe 3 janë të pa firmosura;
4. Deklarata e Kandidatit (Model 05) për kandidatin për deputet me numër rendor 4, z. Ilir Topi, **Qarku Korçë**, rezulton i pa plotësuar;
5. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 3, zj.Lindita Buxheli, **Qarku Fier** rezulton se pika 6 është e paplotësuar;
6. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 5, z. Baftjar Zeqaj, **Qarku Fier** rezulton se mungon faqja nr. 2;
7. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 16, z. Ergest Krakulli, **Qarku Fier** rezulton se pika 8 është e paplotësuar por ka specifikuar të dhëna;
8. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 5, z. Benard Palaj, **Qarku Lezhë** rezulton se mungon faqja nr. 6;
9. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 6, z. Ilir Metaj, **Qarku Vlorë** rezulton se në rubrikën “A” nuk është plotësuar nr ID;
10. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 12, zj. Laura Ferati, **Qarku Vlorë** rezulton se në rubrikën “A” nuk është plotësuar nr ID;
11. Deklarata e Kandidatit (Model 05) dhe (Model 07) për kandidatin për deputet me numër rendor 3, z. Halim Dauti, **Qarku Kukës** , rezulton i pa plotësuar.

Në bazë të nenit 73 pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dokumentacioni i depozituar kthehet për korrigjim, subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

### PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72 dhe 73, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”.



## V E N D O S :

1. Kthimin për korrëjrim të listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore Qarku Elbasan, pasi nuk është në përputhje me kriterin gjinor të përcaktuar në pikën 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
2. Kthimin për korrëjrim, për gjetjet e tjera të renditura më sipër, të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet, të “Partisë Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.
3. Dokumentacioni i korrëjruar të depozitohet brenda datës 16.03.2021.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

